

PLATFORMA E OBJEKTIVAVE SI KANDIDATE PËR ANËTARE E KLP-së

Përbajtja

1. Hyrje. 2. Zbatimi i rregulloreve që trajtojnë aspekte të karrierës së prokurorëve. 3.1. Procesi i rekrutimit të magjistratëve. 3.2. Praktika profesional e magjistratëve. 4. Vlerësimi i veprimtarisë profesionalë dhe etike të prokurorit. 5. Vlerësimi i përgjegjësisë disiplinore të prokurorëve. 6. Garancitë e tjera ligjore në ushtrimin e detyrës së prokurorit. 7. KLP-ja, publiku dhe media.

1. Hyrje

Në këto dy vite të funksionimit të KLP-së konstatoj me kënaqësi se ky institucion ka përbushur me profesionalizëm pritshmëritë e sistemit të Prokurorisë, sistemit të drejtësisë në tërësi dhe opinionit publik lidhur me rolin si institucioni kryesor qeverisës i sistemit të Prokurorisë.

Ky pozicion i tillë i KLP-së i përcaktuar nga Kushtetuta dhe roli i tij bëhen vecanërisht të rëndësishme në fazën aktuale tranzitive ku gjendet procesi i reformimit të drejtësisë shqiptare. Konteksti aktual, ku vijon të zhvillohet procesi i reformimit të drejtësisë, i kryer paralelisht me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëvë, ka krijuar vështirësi në realizimin në kohë të disa prej funksioneve të KLP-së që burojnë prej Kushtetutës, ligji për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në këtë drejtim, vlerësoj se ka ende punë dhe kërkohet ende akoma një angazhim i madh me qëllim përballimin e sfidave të përditshme që has sistemi i drejtësisë, por në vecanti sistemi i prokurorisë.

Objektivat që do të jenë në fokusin e punës sime, nëse do të zgjidhem në pozicionin e anëtares së KLP-së, do t'i paraqës më poshtë në një rend logik dhe kronologjik, në përputhje me detyrimet ligjore që duhet të përbushë anëtari i KLP-së si edhe ecurinë e rritjes dhe karrierës profesionale në sistemin e Prokurorisë.



2. Zbatimi i rregulloreve që trajtojnë aspekte të karrierës së prokurorëve

2.1. KLP-ja në vlerësimin tim ka kryer një punë të konsiderueshme në hartimin e rregulloreve për caktimin e përkohshëm, transferimin e përkohshëm, të ngritjes në detyrë, lëvizjes paralele. Si objektiv i imi, në kuadër të plotësimit të kuadrit nënligjor, që ka si objekt aspekte të ndryshme të karrierës së prokurorëve, do të jetë angazhimi aktiv në procesin e hartimit të akteve nënligjore lidhur me përmirësimet e rregulloreve të mësipërme, komandimet e magjistratëve dhe ndihmësmagjistratëve, si edhe konfigurimin e skemës së delegimit, si elementë të rëndësishëm të zhvillimit të karrierës së prokurorëve, duke u mbështetur gjithnjë në parimet e ligjshmërisë, të procesit të rregullt ligjor dhe meritokracisë.

2.2. Ky objektiv përbën sigurisht një temë me mjaft interes për prokurorët që ushtrojnë në mënyrë të përditshme detyrën e tyre në përballje me fenomene dhe problematika të ndryshme. Pritshmëritë e ligjshmëri të cdo prokurori me integritet dhe profesionist, për më tepër në periudhën aktuale të vazhdimit të reformimit të sistemit të drejtësisë, imponojnë zbatimin me korrekëtsi të rregulloreve të mësipërme dhe përmirësimin e tyre, kur është e domosdoshme.

2.3. Është fakt i pamohueshëm që përgjatë 30 viteve tranzicion, jo vetëm legjislativi, por edhe sistemi i Prokurorisë nuk ka ofruar apo parashikuar zgjidhje konkrete për mënyrën e zhvillimit të karrierës së prokurorëve. Por kësaj periudhe tejet të gjatë duhet t'i vijë fundi dhe nismat e ndërmarrja nga KLP-ja në këtë drejtim, nëpërmjet akteve të mësipërme dhe ato që do të jenë të nevojshme në vijim, përbëjnë një gur kilometrik në ngritjen e një sistemi bashkëkohor të prokurorisë.

2.4. Realizimi i këtij objektivi do të arrihet përmes një roli konstruktiv dhe bashkëpunimi me anëtarët e tjera të Këshillit, duke marrë në konsideratë mirëfunksionimin e zyrave të prokurorive dhe nevojat e kërkesat e prokurorëve. Sipas konceptit tim, në Prokurori duhet të mbizotërojë fryma e konkurrimit të ndershëm, garës me rregulla të barabarta dhe vlerësimit të meritës së gjithësecilit.

2.5. Në këtë formë, Prokuroria mund të jetë një shembull pozitiv edhe për të gjitha institucionet apo organet e tjera shtetërore. Rregulloret e miratuara dukshëm mbështesin këtë frymë, por e rëndësishme aktualisht e në vijim është që edhe mënyra e zbatimit të tyre të jetë e tillë. Mosrealizimi i një objktivi të tillë do të ishte zhgënjes dhe rikthim pas për Prokurorinë Shqiptare dhe do të tregonte mungesën e reformimit së brendshmi të Prokurorisë.

2.6. Lidhur me sa më sipër, cdo vendimmarrje e imja personale, në kuadër të kolegjalitetit të KLP-së, në rast të zgjedhjes si anëtare e KLP-së, do t'i nënshtrohej respektimit rigoroz të parimeve, rregullave dhe kriterieve të parashikuara në rregulloret e mësipërme.



3.1 Procesi i rekrutimit të magjistratëve

3.1.1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në drejtim të përcaktimit rregullave të qarta që normojnë mënyrën e zhvillimit të karrierës së prokurorëve, duke filluar që me procesin e rekrutimit të kandidatëve për magjistratë. Në bindjen time si kandidat për anëtar i KLP-së, miratimi i rregullores për përcaktimin e procedurave për emërimin si magjistrat dhe caktimi në pozicion i kandidatëve për prokurorë, si edhe zhvillimi i karrierës së prokurorëve, miratuar me Vendimin nr.171, datë 27.09.2019 të KLP-së, përbën një gur themeli në ngritjen e sistemit të Prokurorisë.

3.1.2. Si objektiv i imi si kandidate për anëtare e KLP-së, vlerësoj se lidhur me procesin e rekrutimit te kandidatëve për magjistratë, është e nevojshme mbështetja e një procesi të rregullt ligjor, të kujdeshëm e transparent, duke qenë se jo vetëm aktualisht, por edhe për të ardhmen, ky do të jetë momenti përcaktues i furnizimit me burime njerëzore të sistemit të Prokurorisë. Për rrjedhojë, është e nevojshme një vëmëndje e shtuar në këtë proces, e cila duhet t'i përgjigjet dy kërkësave, së pari plotësimin e boshllékut të shkaktuar nga procesi i rivlerësimit kalimtar dhe së dyti, ruajtjen e domosdoshme dhe të panegociushme të cilësisë së kandidatëve për magjistrat.

3.1.3. Rëndësia e këtij procesi fillon që në momentin që Këshilli ka detyrimin që për cdo fillim viti të kryejë një analizë të hollësishme dhe një projeksion të saktë e të qartë të nevojave të sistemit të prokurorisë, vecanërisht të prokurorive të rretheve gjyqësore dhe atyre të apeleve, duke përcaktuar në këtë mënyrë numrin e magjistratëve-prokurorë që janë të nevojshëm për sistemin e prokurorisë për cdo vit. Në vijim është i nevojshëm verifikimi i hollësishëm për përbushjen e kritereve ligjore ana e kandidatëve për magjistratë dhe më pas të atyre që fitojnë Shkollën e Magjistraturës, duke verifikuar pasurinë dhe figurën.

3.1.4. Ky aspekt është tejet i rëndësishëm në mënyrë që sistemi i prokurorisë, në vecanti, të jetë në perspektivë një sistem efikas duke e bërë të largët mundësinë që ai t'i nënshtrohet sërisht një reforme kaq të thellë, sa kjo që po zhvillohet aktualisht me procesin e vettingut dhe ngritisë së institucioneve të reja, si edhe për t'i paraprirë problematikave që po përballim rëndom aktualisht, të cilat e kanë cenuar veprimtarinë e Prokurorisë, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me mangësitë e organikave të zyrave të prokurorive, ngarkesave të larta në punë, mungesën e besimit të publikut, medias etj.

3.2 Praktika profesionale e magjistratëve

3.2.1. Një tjetër objektiv që e konsderoj të rëndësishëm, të lidhur me atë cka kam shprehur më lart, vlerësoj monitorimin më të kujdeshshëm të praktikës profesionale të kandidatëve për



magjistratë, dhe ndërtimin e ngritjen e komunikimit e bashkëpunimit zyrtar me KLGJ-në në përputhje me detyrimet që parashikon neni 33, pika 9 e ligjit per statusin, i cili imponon bashkëpunimin e Këshillave për hartimin e rregullave të përbashkëta për procesin e praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë, si edhe vëmëndje e shtuar në fazën e emërimit të të diplomuarve nga Shkolla e Magjistraturës si magjistrat.

3.2.2. Në vlerësimin tim Këshilli i Lartë i Prokurorisë duhet të synojë, së bashku edhe me Shkollën e Magjistraturës dhe aktorët e tjera, ku edhe të bëhen propozimet përkatëse ligjore nëse kjo është e mundur, që praktika profesionale t'i rikthehet sërisht traditës dhe skemës së përdorur disa vitë më parë, kur detyra e prokurorit ushtrohej efektivisht në periudhën e praktikës profesionale. Kjo do të kishte vetëm efekte pozitive, pasi jo vetëm që magjistratët prokurorë do të integroheshin dhe përshtateshin më shpejt me specifikat e punës së prokurorit, por nga ana tjetër do të kishte impakt pozitiv në veprimtarinë e prokurorive përkatëse, në drejtim të menaxhimit të problematikave të organikës së prokurorisë dhe ngarkesës në punë.

4. Vlerësimi i veprimtarisë profesionale dhe etike të prokurorit

4.1. Lidhur me procesin e vlerësimit të veprimtarisë profesionale dhe etike të Prokurorëve, vlerësoj se objektiv i rëndësishëm është realizimi i vlerësimeve të drejta e të merituarë përgjithësecilin prej kolegëve prokurorë, të bazuar mbi parimin e meritokracisë, ligjshmërisë dhe zhvillimit të karrierës, duke marrë në konsideratë të gjithë komponentët e parashikuar nga ligji përkryerjen e një vlerësimi objektiv.

4.2. Në cilësinë e kandidates për anëtarë e KLP-së vlerësoj se është e nevojshme trajtimi i kësaj cështje me përparësi nga këshilli dhe në bashkëpunim me anëtarët e tij, evidentimi i mekanizmave për të vënë në jetë këtë proces, i cili duhet përmendur se për shkaqe që unë i kam cituar në pjesën hyrëse të kësaj platforme, nuk ka nisur ende. E rëndësishme, në perspektivë është që procesi i vlerësimit të prokurorëve në asnjë moment dhe për asnjë arsyë të mos përdoret si element apo mjet që mund të ndikojë në pavarësinë e brendshme dhe të jashtme të prokurorëve. Në cdo rast kjo e fundit duhet të stimulohet dhe të ruhet e pacenuar.

4.3. Fillimi i zbatimit të këtij procesi do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në garantimin e objektivitetit të proceseve të tjera të përmendura edhe në pjesë të tjera të kësaj platforme, ku më e rëndësishme është ajo e zhvillimit të karrierës së prokurorëve. Në cdo rast, vendimmarrjet mbi karrierën e prokurorëve do të duhej të merreshin në përputhje edhe me rezultatet e procedurës së vlerësimit. Jo pa qëllim ligji ka parashikuar se në këtë proces zbatohet edhe parimi i efikasitetit, që ndër të tjera, nënkupton që *vlerësimi i veprimtarisë kryhet nëpërmjet një procesi të shpejtë, me anë të procedurave të thjeshta dhe në afate kohore të arsyeshme për të siguruar të dhëna në kohën e duhur për karrierën e magjistratit.*



4.4. Për të kryer procesin e vlerësimit është e rëndësishme, ndër të tjera, zbatimi i procesit të rregullt ligjor në procedurën e vlerësimit të prokurorit, element, të cilit do t'i kushtoja një rëndësi të vecantë, nëse do të zgjidhesha në pozicionin e anëtares së KLP-së. Ligji e ka dhënë në mënyrë të detajuar kuptimin e parimit të procesit të rregullt ligjor, sipas të cilit *në procedurën e vlerësimit respektohen standardet e procesit të rregullt ligjor përmagjistratin, duke përfshirë të drejtën përmes t'u njothur me aktet, të drejtën e aksesit në dosjen e vlerësimit, të drejtën përmarrë pjesë në proces, të drejtën e kontradiktoritetit, të drejtën përmes t'u dëgjuar, të drejtën përmes t'u mbrojtur, të drejtën përmes t'u pasur një akt vlerësimi të arsyetur dhe të drejtën përmes t'u ankuar mbi aktin e vlerësimit;*

5. Vlerësimi i përgjegjësisë disiplinore të prokurorëve

5.1. Lidhur me procesin e shqyrtimit të përgjegjësisë disiplinore të prokurorëve, vlerësoj si objektiv të rëndësishëm zbatimin e procedurave përkatëse të bazuara mbi parimin e së drejtës përmes një proces të rregullt ligjor, parimit të ligjshmërisë, të moscenimit të pavarësisë së prokurorit, duke garantuar nga njëra anë ligjshmërinë në ushtrimin e funksioneve nga ana e Prokurorëve dhe nga ana tjetër duke garantuar mbrojtjen e integritetit dhe figurës së secilit Prokuror nga akuzat apo nga pretendimet e pabazuara.

5.2. Në vlerësimin tim një kujdes i shtuar është i nevojshëm në trajtimin e cështjeve të tillë nga ana e Këshillit. Respektimi i garancive procedurale përmagjistratin në një proces të tillë është i panegociushëm. Ky proces është një proces delikat, që nuk duhet të ndikohet nga faktorë të jashtëm apo të brendshëm, pasi kompromenton drejtpërdrejtë jo vetëm pavarësinë e një prokurori të caktuar, por minon sistemin e Prokurorisë në tërësi.

6. Garancitë e tjera ligjore në ushtrimin e detyrës së prokurorit

6.1. Jo më pak të rëndësishme do të vlerësoja dhe konsideroja edhe respektimin e zbatimin e garancive lidhur me lehtësitetë në ushtrimin e detyrës së prokurorit, pagën dhe përfitimet e tjera financiare (ulja e kohës së punës, ulja e ngarkesës, përfitimi i kredisë etj), siguria në punë etj. Në dukje elementë të tillë duken të parëndësishme, megjithatë ato kanë rëndësi parësore, përmes se risitë që prezanton ligji përmes statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në këtë drejtim, përbëjnë fakt premisat përmes rrjetit e përgjegjshmërisë dhe garantimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së prokurorëve në kryerjen e detyrës.

7. KLP-ja, publiku dhe media

7.1. Së fundi, por jo për nga rëndësia, do të vlerësoja si një objektiv të rëndësishëm personal, por edhe për trupën e KLP-së vazhdimin e politikës së rritjes së transparencës dhe përgjegjëshmërisë përpara opinionit publik dhe faktorëve të tjera, vecanërisht medias, të çdo vendimmarje apo qendrimi të këtij institucionit, i cili pa dyshim që kontribuon në forcimin e sistemit të drejtësisë dhe përmirësimit të perceptimit të punës së Prokurorëve dhe Prokurorisë në përgjithësi.

Në përfundim dëshiroj të vlerësoj se platforma përfshin në mënyrë të përbledhur cështjet kryesore, zgjidhja e të cilave është kompetencë e KLP-së dhe që kanë impakt në jetën profesionale të cdo prokurori.

**Kandidate për Anëtare e KLP-së
ELOIDA GOXHI**

